



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE
MBI
PEZULLIMIN E SHITJES DHE SHLYERJES SË KUOTAVE NË FONDET E
INVESTIMEVE

Miratuar me vendimin e Bordit nr.154, datë 29.09.2016

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kushteve dhe procedurave për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave në fondet e investimeve.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore do të zbatohet nga subjekte që janë të licencuara dhe të mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtari si shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe nga subjekte të licencuara si banka depozitare.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 2, paragrafi 7, të Ligjit 36/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim dhënë atyre në Ligj.

Neni 4

Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:
 - a) “mjet i qëndrueshëm komunikimi” - do të konsiderohet çdo mjet komunikimi (e-mail, disketë, CD-ROM, DVD), i cili përmbush të tre kriteret e mëposhtme:
 - o Lejon që informacioni të adresohet personalisht te marrësi;
 - o I mundëson marrësit ruajtjen e informacionit për ta përdorur për referencë në të ardhmen, për një periudhë kohe të mjaftueshme për qëllimet e informacionit, dhe;
 - o Lejon kopjimin/riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur.

Neni 5

Parime të Përgjithshme

1. E drejta e kuotambajtësve për të blerë dhe shlyer kuotat në fondet e investimeve, sipas përcaktimit të ligjit në fuqi, mund të preket në raste të rrethanave të jashtëzakonshme.
2. Pezullimi i përkohshëm i shitjes dhe shlyerjes së kuotave të fondeve të investimeve, lejohet vetëm në rastin e mbrojtjes së interesit të investitorëve të fondeve apo investitorëve të mundshëm të tyre.
3. Rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara, përtej kontrollit të shoqërisë administruese ose depozitarit, mund të sjellin pamundësinë e vlerësimit, shitjes apo shlyerjes së pagesës së një pjese ose të të gjitha aseteve të fondit të investimit ose të një pjese të tyre.
4. Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave të fondit të investimit, do të vazhdojë vetëm për periudhën që është e nevojshme mbrojtja e interesave të kuotambajtësve të fondit të investimit brenda kufirit maksimal të përcaktuar në ligj.

Neni 6

Rrethanat e jashtëzakonshme për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave

1. Rrethanat e jashtëzakonshme, të cilat përbëjnë arsye të forta dhe të justifikuar për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave konsiderohen:
 - a) Ngjarjet politike, ekonomike, ushtarake, ngjarjet e politikës monetare ose sociale, greva ose raste të tjera të forcës madhore, në ndikimin e të cilave vlerësimi, blerja apo shitja e aseteve të fondit nuk është e mundur të kryhet siç do të kryhej në kushte normale.

- b) Situatat e krizave financiare që çojnë në mbylljen e tregjeve financiare, në të cilat janë investuar një pjesë e konsiderueshme e aseteve të fondit të investimit.
 - c) Ndërprerja apo prishja për arsye madhore e mjeteve të zakonshme të komunikimit të përdorura për të llogaritur vlerën neto të aseteve të fondit.
 - d) Raste të tjera të gjykuara nga Autoriteti si të nevojshme për të mbrojtur interesat e kuotambajtësve në një fond apo fonde të veçanta.
2. Përveç paragrafit 1, të këtij neni, rrethanë e jashtëzakonshme do të konsiderohet edhe rasti kur, pas përmbushjes së detyrimeve nga shoqëria administruese për administrimin sa më të mirë të likuiditetit, në zbatim të kërkesave ligjore dhe rregullative, janë ezauruar të gjitha mjetet e arsyeshme për të siguruar likuiditetin e fondit të investimeve.
3. Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave të fondit të investimit nga shoqëria administruese bëhet pas dhënies së pëlqimit nga depozitari.
4. Autoriteti, në përmbushje të funksioneve të tij, mund të urdhërojë shoqërinë administruese dhe depozitarin të pezullojë shitjen dhe shlyerjen e kuotave, në rrethana kur është e nevojshme mbrojtja e interesit të kuotambajtësve në një fond të veçantë investimi.

Neni 7

Komunikimi për pezullimin e tregtimit të kuotave

1. Shoqëria administruese dhe depozitari i komunikojnë Autoritetit me shkresë dhe nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi vendimin e pezullimit të shitjes dhe shlyerjes së kuotave të fondit të investimit dhe arsyet e dokumentuara brenda një ore nga marrja e këtij vendimi.
2. Autoriteti, pas marrjes së njoftimit nga shoqëria administruese dhe depozitari vlerëson situatën dhe në rast të ndonjë kundërshtimi për pezullimin urdhëron shoqërinë për të rifilluar shitjen dhe shlyerjen e kuotave të fondit të investimit.
3. Shoqëria administruese e fondit duhet të sigurojë që në faqen zyrtare të saj dhe me çdo mjet të qëndrueshëm komunikimi, të publikohen arsyet e pezullimit, si dhe detaje të mjaftueshme për mbajtësit e kuotave për t'i informuar siç duhet në lidhje me pezullimin, duke përfshirë, në rastet kur bëhet e ditur, edhe kohëzgjatja e mundshme e pezullimit.
4. Njoftimi nga ana e shoqërisë administruese duhet të behet menjëherë publik ndaj investitorëve dhe të:
- a) Tërheqë vëmendjen e veçantë të mbajtësve të kuotave për rrethanat e jashtëzakonshme të cilat çuan drejt pezullimit;
 - b) Jetë i qartë, i drejtë dhe jo i pavërtetë/keqorientues;
 - c) Orientojë mbajtësit e kuotave se si të marrin informacionin e detajuar;

- d) Bëjë me dije kuotambajtësit në rast të përfundimit të pezullimit nëpërmjet publikimit të njoftimit në faqen zyrtare të saj dhe një mjeti të qëndrueshëm komunikimi.
5. Në rastin kur Autoriteti i kërkon shoqërisë administruese dhe depozitarit të pezullojë shitjen dhe shlyerjen e kuotave të fondit të investimi, në faqen zyrtare të Autoritetit duhet të publikohen arsyet dhe kohëzgjatja e pezullimit, në rastet kur kjo e fundit dihet.

Neni 8

Metoda e pranimit të kërkesës për shitje dhe shlyerje të kuotave

1. Kërkesat për shlyerje, të marra gjatë pezullimit të shitjes dhe shlyerjes së kuotave, duhet të regjistrohen sipas renditjes së marrjes së kërkesës, duke mos lejuar që asnjë investitor i fondit të ketë një pozicion të favorizuar.
2. Kërkesat për shlyerje të marra para pezullimit, të cilat nuk janë shlyer akoma, do të regjistrohen me çmimin e kuotës mbështetur në vlerën neto të aseteve të ditës kur është bërë kërkesa.
3. Gjatë pezullimit të kuotave, shoqëria administruese nuk duhet të nënshkruajë marrëveshje investimi për shitje kuotash.

Neni 9

Detyrimet e shoqërisë administruese

1. Kërkesat për shlyerjen e kuotave të marra gjatë pezullimit të shitjes dhe shlyerjes së tyre, do të ekzekutohen me çmimin e kuotës të fondit të përcaktuar në ditën e përfundimit të pezullimit, pasi është publikuar në kohën e duhur në faqen e internetit të shoqërisë administruese.
2. Shoqëria administruese duhet të ketë një procedurë të shkruar e cila duhet të ndiqet në situatat e pezullimit të shitjes dhe shlyerjes së kuotave, dhe duhet të përfshijë planin e komunikimit me depozitarin, Autoritetin, dhe mbajtësit e kuotave.
3. Rifillimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave duhet të zbatohet sapo shkak/shkaqet për pezullimin të mos qëndrojnë më.
4. Shoqëria administruese dhe depozitari duhet të njoftojnë Autoritetin brenda një ore nga marrja e vendimit për rifillimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave.
5. Me rifillimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave, shoqëria administruese duhet të paraqesë brenda një ore pranë Autoritetit çmimin e kuotës së fondit, i cili është rakorduar më parë me depozitarin.
6. Nëse pezullimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave zgjat për më shumë se 28 ditë, shoqëria administruese dhe depozitari do të rishqyrtojnë rrethanat e pezullimit dhe do të raportojnë në Autoritet, ky i fundit mund të japë miratimin për zgjatjen e kësaj periudhe.

7. Nëse shlyerjet neto janë negative dhe përbëjnë një ose më shumë se një përqind e vlerës së aseteve neto në çdo ditë për më shumë se 5 ditë pune rradhazi, ose përbëjnë 5 përqind ose më shumë e vlerës së aseteve neto të fondit në një ditë pune, shoqëria administruese duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin dhe të raportojë çdo ditë nivelin e shlyerjeve neto, si vlerë dhe si përqindje e çmimit të kuotës mbështetur në vlerën neto të aseteve, për 10 ditët vijuese të punës.
8. Shoqëria administruese duhet të publikojë në prospektin e çdo fondi të saj, se pezullimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave është i lejueshëm, kur për shkak të rrethanave të papritura jashtë kontrollit të shoqërisë administruese është e pamundur të përcaktohet vlera e saktë e kuotës. Gjithashtu të paraqitet në prospekt dhe mënyra sesi ky pezullim do t'i komunikohet kuotambajtësve.

Neni 10

Kushtet e përcaktimit të çmimit të kuotës, kushtet e pagesave dhe të rifillimit të operacioneve

1. Shoqëria administruese duhet të vlerësojë kërkesat për shlyerje të marra gjatë pezullimit, me çmimin e kuotës së fondit sipas ditës së përfundimit të pezullimit.
2. Periudha e përmendur në nenin 117, paragrafi 3, të Ligjit të SIK, i ndryshuar, do të jetë 7 ditë nga dita e përcaktimit të çmimit të kuotës në momentin e rifillimit të shitjeve dhe të shlyerjeve, nëse kjo është deklaruar në prospekt dhe/ose në rregullat e fondit.
3. Gjatë pezullimit, shoqëria administruese duhet të njoftojë çdo person që kërkon të blejë ose shlyejë kuota, se të gjitha tregtimet me kuotat e fondit janë pezulluar dhe se ky person ka mundësi për të tërhequr kërkesën gjatë periudhës së pezullimit ose kërkesa e tij mund të realizohet në rastin e parë, pasi pezullimi mbaron.

Neni 11

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.